



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201155/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Shkodër.

Drejtuar: Drejtues i parë Hamdi FJORA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër

SHKODËR

Kryekomisar Asllan SHYTI
Shef i Komisarariatit të Policisë Shkodër

SHKODËR

Për dëgjim: Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe në nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në vendet ku privohet liria e personit, ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, në Drejtorinë Vendore të Policisë (DVP) Shkodër.

Inspektimi u krye në datën 15.09.2022, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", në Procedurën Standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së

Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të bëra nga inspektimi i vitit të kaluar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit, u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Shkodër z. Asllan Shyti dhe shefin e Rendit dhe Policimit në Komunitet, të cilët u vunë në dijeni, lidhur me qëllimin e inspektimit.

Qëllimi i inspektimit të MKPT-së ishte monitorimi i respektimit të situatës së të drejtave dhe lirive të njeriut, të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë, duke përfshirë këtu kushtet infrastrukturore, respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale të tyre të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin “Për Policinë e Shtetit”, ofrimin e shërbimit shëndetësor, verifikimin e rasteve të pretenduara për ushtrim dhune, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm¹.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve dhe të ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona. Gjatë ushtrimit të detyrës për inspektimin e ambienteve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria, grupi inspektues ishte i shoqëruar nga shefi i rendit të Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente.

Pasi mori informacionin e nevojshëm mbi masat e marra për garantimin e të drejtave të personave dhe kushtet e krijuara në këto ambiente, grupi i inspektimit i shoqëruar nga shefi i rendit, vijoi inspektimin në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, si dhe u njoh e administroi kopje të dokumentacionit, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona.

Nga informacioni i mbledhur dhe inspektimi i kryer në mjediset e policisë, rezultoi se gjendja dhe kushtet e krijuara në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në përgjithësi ishin sipas kërkesave dhe parametrave teknike të parashikuara në procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Në kuadër të verifikimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

- ✓ **Ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Komisarariatit të Policisë Shkodër sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde “Rregullat

¹ Shkresë nr.K4/I53-2 prot., datë 13.12.2021 “Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër”.

teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.925, datë 18.07.2019.

- ✓ **Ishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
- ✓ **Ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin në Komisariatin e Policisë Shkodër.
- ✓ **Ishte zbatuar rekomandimi**, për të respektuar të drejtat e personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar, për lejimin e avokatëve të takohen me këto subjekte në çdo kohë dhe sa herë kërkohen prej tyre, sigurimin e psikologëve dhe avokatëve që në momentet e para të shoqërimit të të miturve, si dhe njoftimin sa më shpejt të familjarëve për vendndodhjen e tyre.
- ✓ **Ishte zbatuar rekomandimi**, për garantimin e masave anti COVID-19, si një problematikë evidente dhe e domosdoshme për ruajtjen e shëndetit të punonjësve, si dhe të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar në këtë komisarjat.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet e bëra nuk kishin gjetur ende zbatim, me argumentin se nuk ka fonde në zërin e investimeve në buxhetin e shtetit për këtë qëllim.

- ✓ **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar, ndaluar/arrestuar, në Komisariatin e Policisë Shkodër.
- ✓ **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një ambienti të veçantë për ushtrimin e riteve fetare, në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se në Komisariatin e Policisë Shkodër ishin respektuar procedurat e shoqërimit të personave në konflikt me ligjin sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.925, datë 18.07.2019, por kishte mundësi për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar.

Theksojmë se, gjatë kryerjes së inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë së kësaj drejtorie, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të të gjitha niveleve, u treguan bashkëpunues dhe transparent me grupin e inspektimit.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në DVP Shkodër, ishte pjesërisht të ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ai ndodhej në katin e parë të godinës, dhe përbëhej nga tre dhoma shoqërimi: një (1) për persona të rritur, një (1) për gra dhe një (1) për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe 4x4 m², me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin e personave të shoqëruar. Dritaret e dhomave lejonin mundësinë e ajrimit dhe të ndriçimit të plotë natyral. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjienike. Kapaciteti i ambientit të shoqërimit ishte për mbajtjen dhe qëndrimin maksimalisht të 12 personave, të cilët qëndronin në dhoma të ndara, secila për 4 persona.

Dhomat e shoqërimit kishin ndriçim nga rrjeti elektrik dhe ishin të pajisura secila me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme për qëndrimin ulur të të shoqëruarve. Në hyrje të korridorit ndodheshin 3 tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra, si dhe për punonjësit e policisë, sipas standardeve të miratuara. Ato ishin të pastra dhe të pajisura me dushe, lavaman dhe ujë të rrjedhshëm 24 orë. Në Komisarlatin e Policisë Shkodër kishte sistem qendror për ngrohje/ftohje, për t'u përshtatur kushteve klimaterike për personat e shoqëruar në konflikt me ligjin.

Në hyrje të korridorit të dhomave të shoqërimit ndodhej një dhomë e ndarë me xham në mes për kryerjen e “përgjimit ambiantal dhe njohjes me persona nën hetime penale për veprime procedurale” të bëra nga punonjësi i policisë, sikurse parashikohet në ligj, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga organi i prokurorisë².

Grupi i inspektimit, evidentoi si një praktikë të mirë në Komisarlatin e Policisë Shkodër, investimin e realizuar brenda ambienteve të katit të 2 të godinës së komisarlatit, ndërtuar me mbështetjen e UNICEF dhe Qeverisë Norvegjeze në kuadrin e Programit “Qasja e Fëmijëve në Drejtësi” 2019-2020. Ambienti i intervistimit ishte i dedikuar për të miturit në konflikt me ligjin dhe njëkohësisht për viktimat e dhunës në familje. Përbëhej nga 3 dhoma, si dhoma për marrjen në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore e kompletuar me të gjitha pajisjet e regjistrimit të sistemit audio-viziv, dhoma e punës së punonjësve të policisë që ishin të trajnuar për këtë qëllim, si dhe dhoma e qëndrimit të të miturve, familjarëve, avokatit mbrojtës dhe psikologut, por ato nuk i ishin dorëzuar akoma Komisarlatit të Policisë Shkodër për vënien e tyre në funksion. Gjithashtu, në këtë institucion, ishin trajnuar 2 specialistë vetëm për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve.

Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në dhomat e shoqërimit, u evidentua se në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, me qëllim që këto të drejta të njihen dhe të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar.

Sikurse u evidentua nga informacioni i drejtuesve të policisë, në mjedisin e shoqërimit mungon një dhomë për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar. Aktualisht, intervistimi dhe marrja në pyetje e këtyre personave zhvillohet në zyrat e punës të punonjësve të policisë, në shkelje të kërkesave për kushtet e mbajtjes dhe sigurisë të personave të shoqëruar, të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, ku thuhet shprehimisht se: “Në mjediset ku pyetet i shoqëruari, duhet të jenë vendosur pajisje e orendi pune si: tavolina e karrige për specialistët e policisë, si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilët duhet të jenë të fiksuar dhe të pa lëvizshëm”³. Theksojmë se, zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

² Neni 131, pika 1/a e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

³ Pika 4, kreu VII “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar”.

Avokat i Popullit shpreh shqetësim të thellë që rikonstruksioni ose rindërtimi i ambienteve të reja nuk bëhet mbi bazën e projekteve që të garantojnë kushtet e tyre infrastrukturore që paprashtrohen në aktet nënligjore. Sa më sipër, tregon se nuk ka vullnet për të monitoruar marrjen në pyetje të personave në konflikt me ligjin, në dhoma të posaçëm për intervistim.

Në Komisarlatin e Policisë Shkodër, gjatë periudhës 01.01.2022 deri më 15.09.2022 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **483** persona, ku saktësisht **459** shtetas madhor, **15** shtetas të mitur dhe **9** shtetase gra të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla, që mund të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve të personave të shoqëruar apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Duke qenë se në kohën e kryerjes së inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisarlatit, grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave të shoqëruar në ambientet e Komisarlatit të Policisë Shkodër, nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

Po ashtu, na u referua se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë. Avokati i Popullit kërkon dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore të burgosurve që në momentin e hyrjes në komisarlat.

Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve

Dhomat e sigurisë në Komisarlatin e Policisë Shkodër ishin ndërtuar në përgjithësi, sipas kërkesave të parashikuara në Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambientet e sigurisë ishin në katin e parë të godinës dhe ishin gjithsej 14 dhoma sigurie, me kapacitet 16 persona. Konkretisht 12 dhoma me nga një person secila, ndërsa 2 dhoma të tjera me 2 persona, ku ishin të ndara më vete: 12 dhoma për meshkuj madhorë, 1 për gra dhe 1 për të mitur, persona në cilësinë e të arrestuarve apo të ndaluarve, për të cilët oficerët e policisë gjyqësore kishin marrë masën e arrestimit/ndalimit, sipas Kodit të Procedurës Penale.

Sipas kriterëve për ndërtimin e dhomave të sigurisë⁴, normave dhe parametrave teknike jetësore e të sigurisë për një person të arrestuar/ndaluar, sipërfaqja e përgjithshme e ambientit, duhet të jetë jo më pak se 10 m², e cila duhet të ndahet në ambient qëndrimi me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Lartësia e këtyre ambienteve duhet

⁴ Kreu VIII, pika 3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

të jetë, jo më pak se 2.5 m. Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se, dhomat në ambientin e sigurisë në Komisaratin e Policisë Shkodër plotësojnë kriteret e mësipërme.

Gjithashtu, çdo dhomë ishte e pajisur me një krevat metalik me këmbë të palëvizshme dhe të kompletuar me orënditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje të mirë dhe të pastër. Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe të dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe lavamanë.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (2 dushe), i cili ndodhej në fund të korridorit. Ambienti ku ndodhej dushi me ujë të ngrohtë për larjen e trupit dhe tualetet, ishin të pajisur me nje hidrosanitare dhe furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm, nga rrjeti i UK Shkodër. Po ashtu, në paradhomën e dusheve kishte dhe tualet të përbashkët, i cili ishte i pajisur me të gjitha pajisjet që shërben për këtë qëllim.

Në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohje/ftohjeje me sistem qendror sipas kushteve klimaterike, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për “Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë, në një moment nevojë apo emergjence. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit, në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe për ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë ishte i lidhur me një gjenerator, i cili shërbente si burim alternativ rezervë për ndriçim, në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma e mjekut, e cila shërbente për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar, ruajtjen e dokumentacionit që mbahet prej tij, si dhe mbajtjen e medikamenteve të nevojshme për rastet e urgjencave. Kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit/arrestuarit paraqitej e përkeqësuar, me rekomandimin e mjekut, personi shoqërohej menjëherë për në Spitalin Rajonal të Shkodrës.

Dhoma ishte pajisur me orënditë e nevojshme si shtrat, tavolinë, karrige, raft dhe frigorifer për mbajtjen e medikamenteve mjekësore për personat e ndaluar/arrestuar në Komisaratin e Policisë Shkodër.

Brenda ambientit të sigurisë ndodhej edhe dhoma për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, **e cila nuk ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave.** Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige me këmbë të fiksuara në dysheme, në mënyrë të palëvizshme për qëndrimin ulur të personave që merren në pyetje dhe për përfaqësuesit e organit të akuzës.

Gjithashtu, në këto ambiente kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët e tyre, e cila nuk ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me 3 kamera, përgjatë 24 orëve. Kamerat administroheshin nga punonjësi i IT-së në DVP Shkodër dhe afati i ruajtjes së pamjeve filmike ishte për 30 ditë.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe nga personat e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe të arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me DVP Shkodër dhe servirej me shërbim catering.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve, që dëshironin u lejohej ushtrimi i rriteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i marrë nga punonjësit e policisë, na u sqarua se të ndaluarve/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Në korridorin e këtij ambienti ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të të ndaluar/arrestuar. Në tërësi, posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, ishin të rinj dhe të përditësuar sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e ri të Procedurës Penale. Nuk kishte ambiente ajrimi

Në Komisaratin e Policisë Shkodër, gjatë periudhës 01.01.2022 deri më 15.09.2022 ishin të ndaluar, të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e personave të arrestuar/ndaluar 280 persona, nga të cilët 278 meshkuj madhor dhe 2 të mitur, me probleme me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenit 112/2 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e sigurisë.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë inspektimit, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisaratin e Policisë Shkodër, u evidentua se zbatoheshin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019, ku çdo njësi policie që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të pajiset me regjistrat për evidentimin e të dhënave të personave në cilësinë e të shoqëruarve apo të ndaluarve/arrestuarve në mjediset e policisë. Regjistrat ishin të mbajtur në rregull dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në Policinë e Shtetit” dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, regjistri ishte plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje

shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por jo më shumë se 10 orë në raste të veçanta. Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryhet nga oficeri/agjenti i policisë gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit është jo më tepër se 12 orë⁵.

Në këtë komisariat ndodhej edhe “Regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar”, ku regjistroheshin të dhënat e këtyre personave, sipas procedurave të kryera nga punonjësit e Komisariateve të Policisë Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe. Ky regjistër gjithashtu ishte i sekretuar dhe i plotësuar sipas rubrikave.

Nga këqyrja e këtij regjistri, por dhe nga procesverbalet e personave të ndaluar/arrestuar që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në ambientet e policisë. Kjo praktikë ndiqej nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë në Shkodër, të cilët në procesverbalin e personave të ndaluar/arrestuar që shoqëroheshin për në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër, shënonin orën kur atyre ju privohej liria në momentin e shoqërimit në mjediset e komisariateve respektive. Dokumentimi i saktë i kohës në procesverbalin e personave të ndaluar/arrestuar, që në momentin e privimit të lirisë në mjediset e policisë, përbën garanci për këta persona në llogaritjen e kohës gjatë qëndrimit në këto mjedise, pavarësisht lëvizjeve nga Komisariami i Policisë, për në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër.

Në zyrën e informacionit të Komisarariatit të Policisë Shkodër, ishte hapur një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur, të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar, në bazë dhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim⁶. Për vitin 2012 ishin evidentuar të dhënat për 15 persona të mitur.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nga këqyrja e këtij regjistri u evidentuan më së shumti kërkesa për avokat, komunikim me familjarët etj.

Në Komisariatin e Policisë Shkodër, u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave të ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta me të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe në 8 gjuhë të huaja, të cilat mbaheshin në dhomën e punës dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa apo kërkesa të natyrave të ndryshme.

Ambientet e intervistimit

⁵ Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁶ Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

Në dhomat e shoqërimit të DVP-së Shkodër, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar nga sistemi i kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Si edhe raportuam më lartë, kjo mangësi është e papranueshme pas realizimit të rikonstruksionit të godinës

Grupi i monitorimit, inspektoi zyrat e punës të punonjësve të policisë që kryenin veprime procedurale me personat e shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar. Nga monitorimi, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj personave me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre. Sipas Procedurës Standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019⁷.

Ndërsa në dhomat e sigurisë kishte një dhomë më vete, e cila shërbente për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesi i organit të akuzës si dhe një dhomë për marrjen pyetje nga avokatët e tyre mbrojtës. Kjo dhomë nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave të sigurisë audio-video.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se ky rekomandim sërish nuk është plotësuar⁸.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP Shkodër, grupi i inspektimit konstatoi se në korridoret dhe pranë dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar,

⁷ Referuar kreu XIV pika 6/b procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, përcaktohet se: Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve duhet regjistruar në elektronikë procesi i marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ ndaluarit.

⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18].

por ato kishin nevojë të rifreskohen me të reja. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet dhe në vende të tjera të aksesueshme nga personat që ndodhen në mjediset e policisë, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

Në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit të personave të ndaluar/arrestuar nga grupi i inspektimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Ndërsa, personat e arrestuar/ndaluar që nuk kishin mundësi financiare për të patur avokat mbrojtës dhe kërkonin asistencë juridike, organi i prokurorisë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ju caktonte atyre avokat mbrojtës nga lista e avokatëve të miratuar prej tyre.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe kishte detyrimin të asistonte të miturin deri në përfundim të procedurave përkatëse.

Për shtetasit e huaj të arrestuar/ndaluar komunikimi me punonjësit e policisë dhe prokurorin bëhej në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë, nëpërmjet avokatit apo një përkthyesi. Arrestimi apo ndalimi i tyre kryhej sipas procedurave, duke njoftuar paraprakisht zyrat konsullore të shteteve respektive. Me qëllim njohjen me të drejtat e tyre, për shtetasit e huaj ishte përkthyer deklarata me të drejtat në 10 gjuhët e huaja më të përdorura.

Një vëmendje të veçantë, kësaj çështje i ka kushtuar edhe KPT (CPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, ku në raportin përfundimtar është rekomanduar “Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit”⁹.

⁹ Në lidhje me këtë rekomandim DPSH është shprehur se me anë të shkresës nr. 6104/3, datë 02.09.2019 “Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të CPT-së për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit” është tërhequr vëmendja e të gjitha strukturave vendore të policisë dhe është kërkuar sigurimi i informacionit verbal të qartë dhe të plotë në lidhje me të drejtat e tyre, që nga momenti i parë i privimit të lirisë, plotësimin dhe sigurimit të një kopje të formularit/deklaratës, me shkrim me të drejtat dhe nënshkrimin e tyre pas njohjes.

Nga mbikëqyrja e një fashikulli të dosjes për të arrestuarit/ndaluarit, grupi i inspektimit evidentoi se ai përmbante a) kopjen e procesverbalit të arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori, urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor; b) procesverbalin e kontrollit personal, së bashku me sendet personale të cilat janë konstatuar dhe gjetur gjatë kontrollit, si dhe c) letrën me të drejtat e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga intervistat e zhvilluara me të arrestuarit/ndaluarit, rezultoi se vizita mjekësore nga mjeku i DVP Shkodër, ishte kryer brenda afatit 12 orë nga hyrja e tyre në dhomat e sigurisë¹⁰. Mjeku ishte në organikë të DVP-së Shkodër dhe ishte me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i ambientit të sigurisë së këtij komisariati. Mjeku mbulonte ndërkohë dhe vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në dhomat e sigurisë edhe në Komisaritet e Policisë në varësi të DVP-së Shkodër.

Në nenin 115 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht e drejta për kërkesa dhe ankesa e personave të privuar nga liria në ambientet e policisë, ku thuhet se: “Çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që çenohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t’u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore”.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, në Komisaritetin e Policisë së Shkodrës, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun XIV, pika 6 të procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin nr. 925, dt. 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera, në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar, ndaluar/arrestuar, në Komisaritetin e Policisë Shkodër.

¹⁰ Kreu II, pika 7/b e procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për marrjen në dorëzim dhe vënien në funksion të ambienteve të katit të 2, të godinës së Komisarariatit të Policisë Shkodër, ndërtuar me mbështetjen e UNICEF dhe Qeverisë Norvegjeze në kuadrin e Programit “Qasja e Fëmijëve në Drejtësi” 2019-2020, duke ofruar një ambient të përshtatshëm dhe të rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit në konflikt me ligjin.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të veçantë për ushtrimin e rriteve fetare në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
5. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambineteve të ajrit në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, për persona të ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisarariat.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihem në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI